

VENDIM
Nr.57, datë 2.6.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC I TERVOLIT” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “a” dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.6.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC i Tervolit” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Tervolit dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit, dhe se shoqëria është mbajtëse e një marrëveshjeje koncesioni me një afat 30-vjeçar për këtë hidrocentral,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC i Tervolit” sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Tervolit për një kohëzgjatje prej 30 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta